



RAPORT NDËR VITE
2013-2016

*Institucion solid përmes synimit të përsosmërisë
në zbatim të ligjit dhe rregulloreve*

Tiranë, Prill 2017

Njësitë e audituara

Përmbledhje

Ky raport përfshin aktivitetin dhe performancën e njësisve të Auditimit të Brendshëm të Kolegjit Universitar Bedër për vitet 2013-2016, kundrejt objektivave kryesore vjetore dhe strategjike.

Komisioni:

Rektorati, Kolegji Universitar Bedër,
Tiranë
+355 4 24 19 200

Përmbajtja

- Komisioni i Auditit
- Strategjia
- Baza ligjore dhe metodologjia
- Performanca e punës audituese
- Statusi i zbatimit të rekomandimeve
- Gjetjet kryesore
- Përdorimi i burimeve të auditimit

Komisioni Auditit

Vizioni ynë

Institucion solid përmes synimit të përsosmërisë në zbatim të ligjit dhe rregulloreve

Misioni ynë

Të ndihmojmë institucionin të mbajë lart përgjegjshmërinë e funksionimit në fushën e arsimit të lartë


Vlerat tona

Qëllimi– të kemi një impakt, të jemi të përgjegjshëm dhe të punojmë si një skuadër.

Stafi– ne besojmë dhe respektojmë punën e të tjerëve, dhe kemi një qasje të balancuar në kryerjen e punës.

Profesionalizmi– ne njihemi për pavarësi, integritet dhe vlerat që përcjellim.

Njësitë kryesore



Zyra e Sekretarisë Mësimore

Departamenti i Drejtësisë

Departamenti i Shkencave të Komunikimit

Departamenti i Shkencave Islame

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke

Departamenti i Shkencave të Edukimit

Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike

Dekanati i Studentëve

Biblioteka

IRO

IT

Zyra e Kurrikulave

Zyra e Kordinimit të Programeve Master

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit

Fakulteti i Shkencave Humane

Zyrës së Kërkimit Shkencor

Zyrës së Planifikimit të Karrierës

Kush jemi ne

Komisioni i Auditimit të Brendshëm të Kolegjit Universitar Bedër është autoritet ad hoc i krijuar me urdhër të titullarit të institucionit përgjatë cdo viti akademik me qëllim që të ndihmojë në dhënien e një sigurie relative për të gjitha fushat e veprimtarive të njësisve që mbulojnë aktivitete administrative të bazuara në dokumentacion ligjor.

Baza ligjore dhe metodologjia:

Komisioni i Auditimit të Brendshëm të Kolegjit Universitar Bedër në zbatim të urdhrat të rektorit të Kolegjit Universitar Bedër dhe në mbështetje të Statusit dhe rregulloreve të institucionit ka ushtruar auditimin e dokumentacionit në të gjitha njësitë kryesore dhe zyrat administrative, sipas programit të miratuar nga titullari, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së dokumentacionit me kuadrin

ligjor, udhëzimet, rregulloret dhe vendimet e organeve drejtuese të Kolegjit Universitar Bedër.

Komisioni jep opinion të pavarur mbi veprimtaritë e audituara, dhe identifikon nëse ato janë zhvilluar në përputhje me rregullat në fuqi si dhe në pajtim me ligjin.

Në auditime specifike ne përqipemi të vlerësojmë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke konfirmuar nëse rregulla specifike, rregullore, etj, krijojnë një sistem të fortë të kontrollit të brendshëm, ose nëse ato duhen përmirësuar.

Burimet tona

Në cdo rast janë përdorur burimet ekzistuese me eficiencë të lartë për të përmbushur planin vjetor të auditimit. E gjithë trupa audituese i është nënshtruar kualifikimeve të vijueshme, duke krijuar një arsye të shëndoshë për besim, profesionalizëm, integritet dhe përkushtim.

□ Strategjia

Vizioni Strategjik

Rritja e rëndësisë së auditimit, duke i kthyer rreziqet në rezultate

Misioni strategjik

Të mbështesë institucionin për të ruajtur përgjegjshmërinë në funksionimin bazuar në rregulloret përkatëse përmes zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Prioritetet Strategjike

Ne kemi një fokus strategjik 5-vjeçar. Për periudhën 2012-2017, kemi caktuar strategjitë për të arritur qëllimet tona të pritshme. Qëllimet për secilin strategji, si dhe veprimet mbështetëse janë të detajuara përgjatë planifikimit të aktiviteteve audituese. Prioritetet strategjike në nivel vjetor janë realizuar, si një bazë e mirë për strategjinë 5- vjeçare.

Qëllimet Strategjike

Strategjia jonë është të realizojmë vetëvlerësimin e eficiencës së drejtimit të çështjeve të brendshme me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së dokumentacionit me kuadrin ligjor, udhëzimet, rregulloret dhe vendimet e organeve drejtuese të

Kolegjit Universitar Bedër dhe forcimin e sistemit të kontrollit mbi to.

Për këtë qëllim, ne synojmë që të aplikojmë metodologjitë dhe teknikat më të mira bashkëkohore për të përmirësuar planifikimin për auditim, maksimizimin e kapaciteteve të skuadrës audituese, dhe zgjerimin e mbështetjes në arritjen e objektivave të institucionit tonë.

Prioritete kyçe

Prioritetet kryesore strategjike i janë referuar rritjes së eficiencës së burimeve të auditimit, të orientuara nga analiza periodike e marrëdhënies lidh dhe rregullore-dokumentacion konkret.

Për këtë, janë përcaktuar prioritetet kryesore si vijon:

- Rregulloret mbi të cilat ushtron funksionin e saj njësia e audituar
- Organizimi i Zyrës/Njësisë: Drejtuesi, specialistët, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi
- Komunikimi me njësitë e tjera: Shkresa, vula, nr. i protokollit, nënshkrimi, arkivimi i shkresës
- Format e komunikimit me studentët
- Procedurat në të cilat zyra merr pjesë (regjistrim, transferim, ngrirje studimesh, largim)
- Formularët për studentët (regjistrim, transferim, ngrirje studimesh, largim)
- Rregjistrat bazë; Rregjistrat e notave
- Dosjet e studentëve
- Kontrata tip
- Analizat statistikore për studentët
- Guida e studentëve
- Shkresa hyrëse – dalëse
- Dosjet e studentëve të cilët janë diplomuar
- Dosjet e studentëve të transferuar
- Database i studentëve
- Arkiva e dokumentacionit të provimeve dhe procesverbaleve

□ Treguesit e performancës së auditimit

Nga analiza e treguesve më specifikë të auditimit, rezulton se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e njësisë të audituara për secilin vit respektiv, apo fushat nën auditim. Disa nga treguesit më kryesorë janë:

a) **Gjetjet e auditimit në vlerë:** Gjetjet e auditimit në vlerë i përkasin kryesisht neglizhencave në ndjekjen të një procesi të nisur, sipas të cilave janë adresuar rekomandimet e auditimit për;

i) ndreqje të parregullsisve; dhe ii) ndjekje të proceseve të punës:

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsisve, si dhe parandalimin e shkeljeve.

b) *Masa disiplinore nuk ka patur.* Nuk është evidentuar asnjë rast që kërkon mase disiplinore.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit

Komisioni i Auditimit të Brendshëm në Kolegjin Universitar Bedër e ka konsideruar një nga sfidat e tij ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre, si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara, që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullsisve e gabimeve, dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm. Këtë e bën duke u përpjekur që:

1. Të rrisë bashkëpunimin me njësinë e audituar, me synim që rekomandimet të diskutohen dhe pranohet paraprakisht, duke rënë dakord për zbatimin e tyre.
2. Të kërkojë respektimin e afatit kohor të raportimit të masave të marra nga njësia.
3. Të kërkojë caktimin e një personi përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin e realizimit të tyre.
4. Të përmirësojë cilësinë e rekomandimeve dhe të rrisë dobinë e tyre për njësinë e audituar.

Cilësia e raportimit të auditimit

Komisioni i Auditimit është përqendruar, në respektimin e Standarteve të Raportimit për Auditimin e Brendshëm me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, koncize, të sakta, të bazuara në fakte, dhe mbi të gjitha të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e eficiencës në punë.

Rritja e cilësisë së raportimit do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorim sistematik.

Raportet janë hartuar në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të Udhërrëfyesit specifik. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përmbatjes, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditues.

Burimet e auditimit

Burimet e auditimeve janë alokuar në mbështetje të urdhërave të titullarit të institucionit në vitet akademike respective.

Është konsideruar i rëndësishëm kompozimi i grupeve të auditimit në përputhje me natyrën e njësisë së audituar.